



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0214

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahim Anetare dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AD-STAR, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit me numër të prokurimit 207-25-9871-5-1-1, me 22/06/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e OE AD-STAR me nr. 2026/0214 , e datës 03/04/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit me numër të prokurimit 207-25-9871-5-1-1.
2. Mbetet ne fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit me numër të prokurimit 207-25-9871-5-1-1
3. **Lejohet** kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.12.2025. MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e

prokurimit “Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashegimise Kulturore ne Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit” me nr. të prokurimit: "207-25-9871-5-1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë ,vlera e parashikuar e kontratës: 747,570.60 €.

Me 19.03.20206.MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE “ TONI O.P - Lot 2, HARISI Group shpk- Lot 3,4,5”.

Me 23.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 31.03.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.04.2026, OE KSF MAJOR SH.A. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0214, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënje të kontrates.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AD-STAR”. janë parashtruar si në vijim:

II. KRONOLOGJIA DHE KONTEKSTI I ÇËSHTJES

AD-STAR sh.p.k. mori pjesë rregullisht në procedurat e prokurimit nr. 207-25-9871-5-1-1 dhe 207-25-117-5-1-1, me objekt: Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimisë Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit, të shpallura nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

AD-STAR oferto i në pesë (5) lote:

Loti 1: 140,034.75 EUR — oferta me çmimin më të ulët

Loti 2: 377,104.38 EUR — oferta me çmimin më të ulët

Loti 3: 93,221.26 EUR — i vetmi pjesëmarrës

Loti 4: 37,276.00 EUR

Loti 5: 46,398.00 EUR

Më datë 19.03.2026, AD-STAR u njoftua se eliminohej me arsyetimin se, në zbatim të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016, inxhinierët nuk dispononin vërtetim nostrifikimi të diplomave të fituara jashtë Kosovës.

Më datë 23.03.2026, AD-STAR parashtroi kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues sipas nenit 108/A të LPP-së, me argumentin kryesor se kriteri mbi bazën e të cilit ishte bërë eliminimi nuk ishte pjesë e Dosjes së Tenderit.

Më datë 30.03.2026, Autoriteti Kontraktues nxori vendim refuzimi, të cilin AD-STAR e konteston si të paligjshëm proceduralisht dhe materialisht.

III. SHKELJET E PRETENDUARA

3.1 Shkelja e Nenit 108/A, paragrafët 3 dhe 6 — Mosrespektim i afatit dhe mungesë njoftimi për zgjatje afati

Neni 108/A, paragrafi 3 i LPP-së parashikon se Autoriteti Kontraktues duhet të vendosë mbi kërkesën për rishqyrtim brenda tre (3) ditëve nga pranimi. Kërkesa e AD-STAR u dorëzua më 23.03.2026; rrjedhimisht, afati ligjor 3-ditor skadoi më 27.03.2026, ndërsa vendimi i AK-së u nxor më 30.03.2026.

Paragrafi 6 i nenit 108/A parashikon mundësinë e vetme ligjore për vendosje pas ditës së tretë: njoftimin me shkrim të ankuesit për zgjatje afati brenda afatit fillestar 3-ditor. Ky njoftim duhej të lëshohej jo më vonë se 27.03.2026.

AD-STAR konfirmon se nuk ka marrë asnjë njoftim nga AK — as me shkrim, as me email, as përmes platformës elektronike të prokurimit — për zgjatjen e afatit të rishqyrtimit. Kjo përbën cenim të të drejtës për mjet juridik efektiv dhe e bën vendimin absolutisht të pavlefshëm.

3.2 Shkelja e Nenit 7 LPP — Barazia në trajtim

Aplikimi i Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 si kriter eliminimi, pa qenë pjesë e dosjes, vendos operatorët ekonomikë në pozitë të pabarabartë dhe cenon transparencën dhe konkurrencën e drejtë.

3.3 Shkelja e Nenit 27 LPP — Dosja e Tenderit

Dosja e tenderit duhet të përmbajë të gjitha kriteret që do të përdoren gjatë vlerësimit. Udhëzimi Administrativ nr. 16/2016 nuk figuron në asnjë pjesë të dosjes dhe nuk iu është bërë i njohur operatorëve para dorëzimit të ofertave.

3.4 Shkelja e Nenit 51 LPP — Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes

Kriteret duhet të përcaktohen paraprakisht dhe të përfshihen shprehimisht në dosjen e tenderit. Kriteri i nostrifikimit nuk ka qenë i përcaktuar në dokumentet e procedurës; çdo eliminim mbi këtë bazë është proceduralisht i pavlefshëm.

3.5 Shkelja e Nenit 56 LPP — Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen

Refuzimi i ofertës është i ligjshëm vetëm kur ajo nuk përmbush kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit. Oferta e AD-STAR është refuzuar mbi bazën e një kushti që nuk ekziston në dosje.

3.6 Shkelja e Nenit 59 LPP — Ekzaminimi dhe vlerësimi i tenderëve

Vlerësimi duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kritereve të publikuara. Përdorimi i Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 përbën tejkalim kompetencash dhe vlerësim të paligjshëm.

3.7 Arsytimi i AK-së është i paqëndrueshëm dhe vetëkundërshtues

Interpretimi administrativ nga një institucion tjetër nuk përbën burim të së drejtës për kriter eliminimi. Përdorimi i një interpretimi të papublikuar përbën përdorim të kritereve të fshehta dhe cenon transparencën, barazinë dhe parashikueshmërinë juridike. Kërkimi i interpretimit pas dorëzimit të ofertave tregon se kriteri nuk ka qenë i përcaktuar paraprakisht. Frazja “ju rekomandojmë t’i lexoni ligjet tjera” është e papranueshme, zhvendos barrën tek operatori ekonomik dhe pranon mungesën e qartësisë së dosjes.

3.8 Praktikat e mëparshme të AK

Në procedurat e mëparshme të këtij autoriteti kontraktues, kriteri i nostrifikimit nuk ka qenë bazë eliminimi. Vendosja e tij në këtë procedurë pa publikim paraprak krijon situatë arbitrare dhe shkel nenet 7, 27 dhe 59 të LPP-së.

IV. DËMI MATERIAL

Vendimi i paligjshëm i AK-së ka shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë ndaj AD-STAR. Vlera totale e loteve 1, 2 dhe 3 — ku AD-STAR kishte çmimin më të ulët dhe ishte i vetmi ofertues — arrin në 610,359 EUR. Dëmi material korrespondon me fitimin e munguar nga ekzekutimi i këtyre kontratave. AD-STAR rezervon të drejtën për kompensim sipas nenit 118 të LPP-së.

NË PËRFUNDIM THEKSOJMË SE:

Në dosjen e tenderit nuk është parashikuar si kriter kualifikimi nostrifikimi i diplomave.

Autoriteti kontraktues nuk mund të vendosë kritere të papublikuara.

Udhëzimi Administrativ nr. 16/2016 nuk është përmendur në dosjen e tenderit.

Eliminimi për një kusht të papublikuar bie ndesh me transparencën, barazinë dhe konkurrencën e drejtë.

V. KËRKESA

Në bazë të nenit 109 të LPP-së, AD-STAR kërkon nga OSHP:

Pranimin e ankesës si të afatshme dhe të bazuar;

Pezullimin e menjëhershëm të procedurës sipas nenit 112;

Konstatimin e shkeljes së nenit 108/A paragrafët 3 dhe 6;

Shpalljen e vendimit të AK-së (30.03.2026) të paligjshëm dhe anulimin e tij;

Rivlerësimin e ofertave pa aplikimin e kriterit të papublikuar;

Çdo masë tjetër korrigjuese që OSHP e konsideron të nevojshme.

VI. DOKUMENTET BASHKËLIDHUR

Vendimi i AK-së për refuzim, 30.03.2026;

Kërkesa për rishqyrtim, 23.03.2026;

Njoftimi i eliminimit, 19.03.2026;

Procesverbali i hapjes publike;

Dëshmia e pagesës së tarifës 6,104 EUR (1% e shumës 610,359 EUR).

Bazuar në shkeljet e rënda procedurale dhe materiale të dokumentuara, AD-STAR kërkon shqyrtimin e ankesës dhe rivendosjen e ligjshmërisë në këtë procedurë prokurimi.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimi 1

Është shkelur Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, në veçanti këto dispozita:

Neni 7 – Barazia në trajtim (paragrafët 1, 2 dhe 3)

Autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë trajtim të barabartë, jo-diskriminim dhe transparencë. Aplikimi i një kriteri të papublikuar cenon transparencën e procedurës, vendos operatorët ekonomikë në pozitë të pabarabartë dhe dëmton konkurrencën e drejtë.

Neni 27 – Dosja e tenderit (paragrafi 1)

Dosja e tenderit duhet të përmbajë të gjitha kriteret dhe kërkesat që do të përdoren gjatë vlerësimit. Në këtë rast, Udhëzimi Administrativ nr. 16/2016 nuk është pjesë e dosjes, megjithatë është përdorur si bazë për eliminim, gjë që e bën procedurën jotransparente dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Neni 51 – Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes (paragrafi 1)

Kriteret e përzgjedhjes duhet të përcaktohen paraprakisht, të përfshihen në dosjen e tenderit dhe të jenë të qarta e të barabarta për të gjithë. Në rastin konkret, kriteri mbi të cilin është bazuar eliminimi nuk është përcaktuar fare si kriter përzgjedhjeje.

Neni 56 – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave (paragrafët 1 dhe 3)

Refuzimi i një oferte mund të bëhet vetëm nëse ajo nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Në këtë rast, oferta jonë është refuzuar mbi një kërkesë që nuk ekziston në dosjen e tenderit; për rrjedhojë, refuzimi është i pabazuar në ligj.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve (paragrafi 4)

Vlerësimi duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve të publikuara. Përdorimi i një akti që nuk është pjesë e dokumenteve të tenderit përbën tejkalim kompetencash dhe vlerësim të paligjshëm të ofertave.

Në përfundim theksojmë se:

Në dosjen e tenderit nuk është parashikuar si kriter i kualifikimit nostrifikimi i diplomave. Sipas ligjit për prokurimin publik, autoriteti kontraktues nuk mund të vendosë kritere shtesë që nuk janë publikuar paraprakisht. Udhëzimi Administrativ nr. 16/2016, i përdorur si bazë për eliminim, nuk është përmendur në asnjë pjesë të dosjes së tenderit dhe nuk është bërë kërkesë paraprake për operatorët ekonomikë. Eliminimi për një kusht të paqartë dhe të papërmendur bie ndesh me parimin e transparencës, barazisë, konkurrencës së drejtë dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

Prandaj kërkojmë rishqyrtimin e vendimit të eliminimit dhe pranimin e dokumenteve të dorëzuara, pasi ato përmbushin kriteret e shpallura.

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues – Refuzohet pretendimi ankimor si i pabazuar

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk mund të përfshijë të gjitha ligjet aplikative në Kosovë në Dosjen e Tenderit me qëllim që operatorët ekonomikë t'i verifikojnë dokumentet para dorëzimit. Fakti që është marrë interpretim nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila ka theksuar se një dokument i panostrifikuar në Kosovë është dokument i pavlefshëm si për shtetasit e huaj ashtu edhe për ata vendorë, tregon se Autoriteti Kontraktues është marrë në detaje me ofertën tuaj dhe e ka trajtuar atë, por dispozitat e ligjeve të tjera aplikative në Kosovë kanë çuar në refuzim. Për këtë arsye, me qëllim që herave të tjera të jeni të përgatitur, ju rekomandojmë të lexoni ligjet e tjera që janë më të gjera se kriteret e vendosura në një procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, jeni eliminuar në të gjitha lotet:

Lot 1: 140,034.75 €

Lot 2: 377,104.38 €

Lot 3: 93,221.26 €

Lot 4: 37,276.00 €

Lot 5: 46,398.00 €

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se stafi i paraqitur (inxhinierët) nuk posedon dëshmi për nostrifikimin, përkatësisht njohjen dhe barazvlerësimin e diplomave të fituara jashtë Republikës së Kosovës.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2016 për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Arsimit të Lartë të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, konkretisht nenit 3 (Parimet e përgjithshme dhe barazvlera), pika 6, përcaktohet se shtetasit e huaj janë të obliguar të kërkojnë njohjen dhe barazvlerësimin e diplomave të fituara jashtë Republikës së Kosovës, nëse për këtë kanë interes juridik në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, për të ushtruar veprimtari profesionale ose për t'u angazhuar në institucione brenda Republikës së Kosovës, është e domosdoshme që diplomat e fituara jashtë vendit të jenë të njohura dhe të barazvlerësuara nga autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.04.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0214 ndërsa me datë 20.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0214, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhenje te kontrates dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “AD-STAR ‘’eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0214 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, i pakënaqur me Vendimin (B58) të AK-së për dhënie të kontratës, ka parashtruar ankesë në OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues, pas pranimi të ofertave, ka formuar komisionin për vlerësimin e ofertave dhe, në përfundim të vlerësimit të ofertave, i njofton operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit lidhur me rezultatin e vlerësimit të ofertave, ku OE ankues njoftohet si tenderues i eliminuar në të gjitha lotet.

OE ankues eliminohet me arsyetimin si më poshtë:

OE ankues pretendon se në dosje të tenderit nuk ekziston kërkesa për nostrifikimin e diplomave, rrjedhimisht deklaron se është eliminuar për një kërkesë që nuk është paraparë në dosje të tenderit.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dëshmive, konkretisht kërkesës së dosjes së tenderit, vlerëson se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, sepse një kërkesë e tillë nuk ekziston në dosje të tenderit dhe eliminimi i një operatori ekonomik për një kërkesë që paraprakisht nuk është paraparë në dosje të tenderit është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, ku përcaktohet që:

Neni 56.3 i LPP-së:

“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Nderhyrje restauruese dhe konservuese në asetet e Trashëgimise Kulturore në Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit” me nr. të prokurimit: "207-25-9871-5-1-1".

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/saj, se ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues nuk e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues në teresi përshkak se AK lidhur me pretendimin kryesor të parashtruar nga OE ankues, ka paraqitur një fakt, shkresë/email kontaktues me institucionin përkatës në këtë rast Ministrinë e Arsimit që është në kundërshtim me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues ka vendosur mbi kërkesën për rishqyrtim pas kalimit të afatit prej tre (3) ditësh të përcaktuar në nenin 108/A të LPP-së, si dhe se nuk është njoftuar për ndonjë zgjatje të afatit të vendimmarrjes. PSH pas shqyrtimit të këtij pretendimi, vlerëson se çështja e respektimit të afatit procedural për trajtimin e kërkesës për rishqyrtim nuk paraqet rrethanë që e bën të paligjshëm vendimin e AK-se lidhur me përmbajtjen e çështjes. pasi që ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike të parapara me ligj dhe ka paraqitur ankesë pranë OSHP-së, e drejta e tij për mbrojtje juridike nuk është cenuar. Për këto arsye, PSH konsideron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Ankuesi pretendon se AK nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit **7, 27, 51, 56 dhe 59 të LPP-së** duke kundërshtuar vendimin e AK-se për eliminimin e ofertës së tij me arsyetimin se mungesa e dëshmisë për nostrifikimin e diplomave të stafit profesional nuk ka qenë kërkesë e specifikuar në dosjen e tenderit, PSH pas analizimit të dokumentacionit të lëndës, ka konstatuar se OE ankues ka paraqitur personel profesional me diploma të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës,

PSH vlerëson se kërkesa për njohjen dhe barazvlerësimin e diplomave të fituara jashtë vendit nuk paraqet një kërkesë shtesë të vendosur nga AK gjatë zhvillimit të procedurës, por buron nga dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë vlefshmërinë e kualifikimeve profesionale në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht AK para se të merrte vendimin përfundimtar, ka kërkuar interpretim dhe sqarim nga institucioni kompetent, përkatësisht Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Nga përgjigja e këtij institucioni znj. K.G. Udheheqese e NARCIS/ prane Ministrisë së Arsimit saktësisht me datë 24.02.2026 rezulton se diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës nuk mund të konsiderohen të vlefshme për qëllime profesionale pa kaluar procedurën e njohjes dhe barazvlerësimit sipas legjislacionit në fuqi, pjesë e shkeputur nga email .. “Në përputhje me legjislacionin në fuqi të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale dhe

ato universitare te fituara jashte vendit kur perdoren me qellim punesimine Republiken e Kosoves i nenshtrohen procedures se njohjes/barasvleres ne NARIC. Udhezimi administrative ne fuqi nuk parasheh perjashtime te vecanta per ndonje kategori te caktuar nga procedura e njohjes se diplomave te fituara jasht vendit...” Në këto rrethana,, PSH konstaton se AK ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë njohjen e kualifikimeve profesionale., rrjedhimisht PSH lidhur me kete pretendim ankimor ia fal besimin pergjigjes se dhene nga AK.

Ankuesi pretendon se në procedura të mëparshme të zhvilluara nga i njëjti Autoritet Kontraktues, mungesa e nostrifikimit të diplomave nuk është trajtuar si shkak për eliminim. PSH lidhur me këtë pretendim vlerëson se praktikat e mëparshme administrative nuk mund të krijojnë të drejta të fituara dhe as të zëvendësojnë detyrimet ligjore andaj PSH vlerëson se çdo aktivitet prokurimi duhet të shqyrtohet në bazë të rrethanave konkrete dhe dokumentacionit përkatës të procedurës përkatëse.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e ankues me nr. 2026/0214, duhet të miratohet vetëm si pjesërisht të bazuara ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull ““Nderhyrje restauruese dhe konservuese ne asetet e Trashegimise Kulturore ne Rajonin e Pejës dhe Rajonin e Deçanit” me nr. të prokurimit: "207-25-9871-5-1-1"duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsytet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - AD-STAR**
- Arkivës së OSHP-së: